

Çesk Zadeja, jeta dhe vepra, nga Vasil S. Tole

Sot është një ditë e veçantë. Jemi mbledhur për 95 vjetorin e lindjes të Çesk Zadesë, një figurë madhore e muzikës shqiptare. Në këtë përvjetor prezantohet libri biografik që studiuesi dhe kompozitori Vasil Tole ka shkruar për të. Përpara se të flas më konkretisht për librin, fillimisht, më lejoni të them se ndjem e emocionuar dhe gjithashtu e nderuar që autori Vasil Tole ma besoi pikërisht mua që të flas për këtë libër.

Emri i Çesk Zadesë ka qenë shumë i pranishëm në jetën time. Qysh fëmijë kam dëgjuar shumë të flitet për të nga, im atë i pari, student i tij, që ka ruajtur gjithmonë një respekt e mirënjohje të përveçme. Gjithsesi, momenti kur Zadeja filloi të përvijohet në mënyrë më të plotë tek unë ishte gjatë studimeve të mia universitare. Më duhet të them se periudha e viteve 2000, ku u formuam ne si studentë, kishte një lloj marrëdhënieje pak të nderë me muzikën shqiptare që ishte krijuar në periudhën e diktaturës. Ndjehej një tension, ndonëse jo edhe aq i artikuluar publikisht, mes asaj çfarë duhej shpëtuar dhe çfarë duhej lënë mënjanë. Shenja më e qartë e këtij tensioni ishte mungesa thujse e plotë e veprave shqiptare nga programet e koncerteve. Për studentët si ne, kjo marrëdhënie bëhej edhe më e vështirë për ta shkruar, le të themi, kur nuk kishe një bibliografi muzikologjike e cila të kishte mundur të sillte një reflektim sadopak të thelluar rreth asaj. Në këtë situatë, ama, prania e Çesk Zadesë ngelej e veçantë, aq e veçantë sa ndodhte që të prekte edhe kufijtë e mitikes, të një autoriteti të muzikës shqiptare që i përkiste një dimension tjetër, si në eter. Duhet të kemi parasysh që ishim studentë të një brezi që, ndonëse nuk e njohën personalisht, largimin e tij e kishin shumë të afërt në kohë (kur unë kam kryer studimet nuk ishin bërë ende 10 vjet nga vdekja e tij).

Kështu mund të ndodhte që të kapeshim pas kësaj përmase autoritare, duke e vlerësuar për së largu. Në këtë atmosferë kujtoj si në vitin e tretë m'u caktua si detyrë në muzikologji që të analizoja Koncertin për piano dhe orkestër të Zadesë. Pasi lexoi punimin, Fatmir Hysi, profesori im i muzikologjisë me qetësinë që e karakterizonte, filloi të dekonstruktonte gjithë tekstin duke më lënë të nënkuptoj se ajo çka kisha shkruar, në fakt nuk thoshte gjë veçse shprehje kremtuese dhe përgjithësuese pa mundur të hyjë konkretisht në kuadrin interpretativ të veprës. Në atë çast, "dushi i ftohtë" dekonstruktivist më bëri të reflektoj rreth qasjes më të kujdesshme që duhej të kisha tani e tutje ndaj Zadejës; për të hapur shtigjet e një interpretimi konceptual dhe sistematik të krijimtarisë së tij.

Të gjitha këto refleksione më erdhën në momentin kur fillova të shfletoj librin e Vasil Toles, mbi Çesk Zadenë. Nga bisedat paraprake që kisha bërë me të, e dija sesa i rëndësishëm ishte

ky libër për të; përkushtimin profesional, por edhe shpirtëror që autori kishte investuar te ky libër.

Nga ana tjetër, duke parë vëllimin e librit, vëren sfidën e madhe të tij si autor për të kaluar nëpër duar materialet e tij. Kemi të bëjmë me një dokumentacion shumë të gjerë të prejardhur nga arkivi personal i Zadesë. Janë materiale që në shumicën e rasteve botohen për herë të parë. Në libër gjejmë tipologji të ndryshme dokumentash: foto dhe dokumente zyrtare, shënime personale të ndryshme, epistolar, si dhe dorëshkrime origjinale të partiturash.

Ndërkaq, për ata që punojnë me arkivat, dihet që materialet e botuara përbëjnë në përgjithësi vetëm majën e ajsbergut dhe se pjesa tjetër, qëndron mes rreshtave të librit. Në kushtet e Shqipërisë, kjo nuk është një punë e lehtë, sepse Shqipëria dhe shqiptarët nuk kanë mundur ende të kenë një program specifik ruajtjeje për këtë tipologji dokumentash dhe materialesh të prejardhura nga arkivat personale e familjarë. Shumë nga këta personazhe të muzikës dhe jo vetëm, kanë ikur në atë heshtjen e tyre, ndërkohë që jo gjithmonë është e lehtë për trashëgimtarët që të menaxhojnë këtë lloj dokumentacioni. Fati më i madh i studiuesit është të kesh bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e tyre, çka me sa kuptoj ka qenë e plotë në rastin e familjes Zadeja. Këto materiale, duke u bashkuar pastaj me pjesën e arkivave institucionale janë thelbësore për të përvijuar portretin biografik në mënyrë më të thelluar. Kjo vjen shumë e qartë edhe tek libri në fjalë, tek i cili autori dëshmon një kërkim të kujdesshëm në arkiva të tillë si ai i Teatrit të operas, ku Çesk Zadeja ka punuar një kohë të gjatë; arkivin e radios, etj.

Në vetvete, kjo është një punë që do të duhej ta bënte patjetër Vasil Tole. Nuk e them këtë për t'i bërë qejfin, sesa duke marrë parasysh faktin që çdokush që merr përsipër të shkruajë një biografi për mendimin tim, duhet një "ritual" i caktuar afrimi me personazhin për të cilin shkruan. Punimi në fjalë nxjerr në pah një lidhje të fortë profesionale dhe personale mes autorit dhe subjektit, lidhje e cila konsolidohet shumë sidomos gjatë viteve '90-të. Kjo i takoi të ishte edhe periudha e fundit i jetës e njëherazi edhe një periudhë mjaft dramatike për shoqërinë e kulturën shqiptare.

Fryt i hershëm i kësaj lidhjeje ka qenë libri "Vetparja e procesit" i Zadesë, përgatitur nga Vasil Tole. Ky libër, të cilit Tolja i referohet edhe në librin që prezantojmë sot, tregon qartë përgjegjësinë e fortë që kishte ky intelektual ndaj kredos së vet mbi muzikën. Përmes botimit në fjalë kuptojmë se fakti që vetë Çesk Zadeja ia beson këtë dorëshkrim atij për ta botuar është rrjedhojë e një besimi reciprok të shtresëzuar në kohë përmes bisedave, intervistave apo thjesht ritualit në dukje të zakonshëm e të parëndësishëm të të pirit një kafe me

profesorin. Shpesh ndodh që pikërisht këto rituale të hapin shtigje reflektimi e frymëzimi që ndriçojnë në mënyra të caktuara shtigjet mbi të cilat shkel kërkuesi. Dhe nëse të gjitha këto të marra së bashku i kanë shërbyer Toles për të shkruar këtë biografi që kemi në dorë sot, nga ana tjetër, mendoj që në shtresëzimin e kujdesshëm të kësaj marrëdhënieje qëndrojnë edhe vetë fillimet muzikologjike të Toles. Krahas kompozicionit që ka qenë dhe vazhdon të jetë thirrja primare, mendoj se Çesk Zadeja ka ditur të zgjojë tek ai edhe një thirrje sekondare ndaj shkrimit muzikologjik mbi muzikën.

Pra, *Çesk Zadeja në muzikën shqiptare* duhet lexuar si një biografi e cila është rezultat i një marrëdhënieje vitale mes biografi-shkruesit dhe subjektit. Ajo përfaqëson një bashkim të dy forcave: nga një anë dëshira e autorit për të shkruar “pelegrinazhin tokësor të një njeriu” të madh, po të perifrazonim fjalët Thomas Carlyle, historianit të njohur të shek. XIX, (*Critical and Miscellaneous Essays*, 1838). Forca tjetër vjen përmes aksesit tek pjesa personale e dokumentave. Libri hyn në kategorinë e biografive studimore të natyrës kritike, duke marrë parasysh burimet dokumentare parësore, si dhe aparatit referencial që e shoqëron atë, por nuk qëndron vetëm në fushën e specialistit të ngushtë, përkundrazi, vërejmë që autori nuk ka dashur qëllimisht që të komunikojë vetëm me lexuesin e specializuar, por të kapë një profil më të gjerë muzikofil.

Libri ka një renditje kronologjike. Në kreun e parë njihemi me pjesën e hershme të jetës së Çesk Zadesë, periudhë në të cilën shfaqen prirjet e para të tij për muzikën dhe kontekstet në të cilat ato zhvillohen. Si fillim, shkojmë në Shkodër, në kulturën urbane të këtij qyteti dhe rolin që ajo pati në formimin e tij. Veçohen nga kjo pikëpamje: së pari konteksti françeskan, shumë i rëndësishëm, një periudhë shkollimi në Romë në konservatorin Santa Cecilia, si dhe puna e tij tek Radio Shkodra. Në pjesën e fundit, kemi transferimin e tij drejt Tiranës, ku angazhohet pranë Ansambllit të Ushtrisë.

Kreu i dytë flet për shkollimin e tij në Moskë, në Bashkimin Sovjetik dhe fillimet e karrierës së tij artistike pas kthimit në atdhe. Përfshin një periudhë më shumë se dhjetëvjeçare por mjaft intensive. Kemi përvojën studentore në një nga shkollat më prestigjioze të kohës, por edhe atë njerëzore në një vend me jetë të pasur kulturore, që për ta ilustruar do të mjaftonin vetëm prania e dy figurave të tilla si Prokofiev e Shostakovic. Po kështu, evidentohen sprovat në krijimtarinë studentore, ku spikat mbi të gjitha Tokata për piano, por edhe variacionet për violinë solo, përvoja me këngët popullore që kthehet në kostante të krijimtarisë së tij dhe sigurisht, muzika e filmit. *Skënderbeu* më e njohura, ndërkohë që kemi edhe atë për filmin dokumentar *Shqipëria* (1952), punë këto që e lidhin fort Zadenë me muzikën e filmit. Kjo periudhë mbyllet me Simfoninë, e cilësuar e para. Zadeja kthehet në atdhe, si një nga

protagonistët kryesorë të jetës muzikore. Këtu fillon angazhimin pranë ansamblit të këngëve dhe valleve me një krijimtari të pasur në fushën e përpunimit të këngëve popullore. Kjo përvojë, me sa kuptojmë, i jep shumë dorë për të artikuluar edhe bindjet e tij lidhur me përpunimin e këngës popullore, të cilat do t'i gjejmë në “Vetparja e procesit” (fq. 205- 206) Në këtë pjesë të librit, Tole ka pranë dimensionin profesional me atë personal, çka është e veçantë sepse hedh dritë mbi një periudhë relativisht të vështirë për Zadejën. Nëse nga një anë, karriera e tij shkon drejt konsolidimit të emrit, në anën tjetër, zhvillohen një sërë dramash në jetën personale. Në të gjitha rastet, këto drama personale lidheshin me rrethanat social-politike që jetonte vendi. Kam parasysh këtu martesën dhe ndarjen e tij me Dhora Lekën si dhe ndarjen së gjalli me gruan ruse e vajzën e tyre. Të gjitha këto kanë lënë shenjën e tyre të pashlyeshme edhe në tingujt e krijuar prej tij, sado që ai vetë mund të jetë kujdesur që të mos vërehet një gjë e tillë. Nuk e di, mbase nga forca e sugjestionit, këtë lloj sage personale e gjeta deri diku në Koncertin për piano dhe orkestër kompozuar në vitin 1968 dhe që sic e thashë më sipër u kthye në një lloj sfide për të njohur Zadenë. E dëgjova sërish dhe përshtypja që mora kësaj here kishte të bënte me një sintezë të vecantë ndjesish të cilat kishin të bënin sa me një tribut të përmallshëm të asaj pjese ruso-sovjetike që ishte brenda tij, dhe përpjekja për të gjetur një lloj paqeje me veten dhe atë jetën që do duhej të vazhdonte të jetohej, e gjitha e sendërtuar në tingull.

Sidoqoftë, ky ngelet sugjestionimi im...

Kreu i tretë paraqet vitet aktive të krijimtarisë, të cilat autori i ka kufizuar në periudhën 1956 -1997, pra në rreth 40 vjet. Këtu Tole paraqet qëndrimin e tij ndaj krijimtarisë së Zadejës, pra si themelues dhe lëvrues i parimeve të “shkollës kombëtare” në muzikë, duke e distancuar atë nga modelet e metodës së realizmit socialist. Tole komenton në raportet me institucionet e kontrollit që artistët kishin gjatë komunizmit, si dhe interpreton marrëdhëniet me dy kompozitorë bashkëkohës të Zadesë, Prenkë Jakovën dhe Feim Ibrahimin. Këto marrëdhënie kanë qenë shpeshherë objekt debatesh të natyrës polemike dhe jo gjithmonë të bazuara në fakte specifike. Vaso Tole pëpiqet të japë interpretimin e vet mbi to, duke lënë jashtë frymën polemizuese dhe duke e mbajtur diskutimin në nivelin e integritetit profesional të secilit prej tyre dhe frymës kritike që duhet të ekzistojë gjithmonë, edhe në varësit të rrethanave problematike në të cilat këta kompozitorë vepronin.

Kreu i katërt shqyrton kronologjinë e veprave dhe vjen si listë e anotuar, e pajisur edhe me me referenca mbi burimet e veprave. Kanë rëndësi sidomos burimet e regjistruara, të cilat i shtohen atyre të shkruara dhe ndihmojnë në nivelin aural, dëgjimor për këdo që dëshiron të

thellohet. Kapitujt e 12 autori trajton lidhjen e Zadesë me Kosovën dhe marrëdhëniet që ai ka krijuar me kompozitorë e përfaqësues të shquar të muzikës kosovare. Në këtë rast, autori e lëviz këndin e interesit dhe përmes figurës së Zadesë hedh dritë mbi zhvillimin e dy realiteteve muzikore të ndryshme e deri diku larg njëra tjetrës, por që gjithsesi kërkonin pika takimi dhe forma komunikimi me njëri-tjetrin. Në kronologjinë e veprave, Tole iu ka kushtuar hapësirë më vete edhe kontributeve të tij muzikologjike, që kanë rëndësi në zhvillimin e gazetarisë muzikore në Shqipëri dhe të mendosh që prej të paktën 10 vjetësh tanimë, fatkeqësisht gazetaria e muzikës është e vdekur.

Zadeja është ndër më aktivët në këtë drejtim, qoftë me shkrime recensionale për koncerte, ashtu edhe me analiza. Pa dyshim, pika më me interes e këtij itinerari muzikologjik mbetet debati i vitit 1972 në faqet e gazetës “Drita” mbi muzikën instrumentale simfonike shqiptare, në të cilin Zadeja ishte pjesë.

Kreu përmbyllës fokusohet te vitet e fundit. Edhe këtu, sërish përmes Zadesë autori përpiket të lexojë situatën post-diktatoriale të zhvillimeve muzikore; rëndësinë e Festivalit të muzikës së re shqiptare, i cili frymoi gjatë viteve '90. Në një situatë të tillë shohim që Zadeja vijon të ngelet aktiv në pikëpamje të krijimtarisë, me një seri veprash të cilat meritojnë vëmendje.

Në fund, autori ka vendosur një shtojcë me një seri dokumentash të cilat bëjnë fjalë për përgjimin e Çesk Zadesë nga autoritetet e sigurimit të shtetit. Autori bën komente të shkurtra mbi dokumentet, ndërkohë që, në mënyrë të qëllimshme apo jo, shtojca pasohet nga një larmi faksimilesh dekoratash, titujsh e vlerësimesh që po i njëjti regjim i dha Zadejës. Këtu në fakt, mund të hapej një diskutim i gjerë mbi këtë marrëdhënie ambigue që ekziston midis pushteteve totalitare dhe artistëve, marrëdhënie mbi banalitetin e së keqes, nëse do t'i referoheshim Anna Arendit, por edhe mbi një çështje që mbetet ende për t'u shqyrtuar: sa arrinte vërtet totalitarizmi të kontrollonte metafizikën tingullit dhe sa rol luanin në këtë ata njerëz që duke mos dalë dot nga skemat shabllon përdornin retorikën mbi realizmin socialist në muzikë për t'u mbrojtur e për të sulmuar. Autori nuk ka dashur që të hyjë në këtë pjesë diskutimi, mbase edhe sepse kjo do të përbënte një temë më vete, por pa dyshim kjo është një lloj ftese e tij për të reflektuar.

Besoj se me këtë libër mbyllet edhe një fazë e qasjes në tërësinë e vet, totalitare, të jetës e veprës së Zadesë, për të hapur pastaj shtigje studimi të përqendruara në aspekte të ndryshme. Në mbyllje, do doja të komentoja një pohim personal, që më erdhi përmes rreshtave. Para pesë vjetësh, në 90-vjetorin e lindjes, i shkrova një letër imagjinare prof. Çeskut, letër që gjendet e botuar në revistën Peizazhe të fjalës, ku ndër të tjera i thoja se

kisha një problem me këtë idenë për ta konsideruar atë si “babain” e muzikës shqiptare. ndjeva që edhe vetë Zadeja ndante të njëjtin mendim. Në fakt nuk do doja të identifikohesh kështu. Ndoshta ngaqë nuk e mendoj muzikën shqiptare si “pjellë” të një babai, që më çon te arketipi, apo autoriteti absolut, por si krijesë të muzave. Qofshin nëntë, si antikitet, apo më shumë kjo ka pak rëndësi. E rëndësishme është që të jenë burim i dijes mbi tingullin. Ajo që mund të themi me bindje është se ai e kishte këtë dije dhe diti ta përdorte me talent, me mençuri, përgjegjësi intelektuale, por edhe me shumë dashuri.